



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr. 4359/2 Prot.

Tiranë, më 22.07.2019

Lënda:

Njoftim

Z. MARJEL MEJDINI

Adresa: Rruga "Zef Jubani", Pallati Bjorn, Kati i 1,

Tiranë

Tel: 0684018096

Në datën 22.07.2019, me urdhër të Drejtorit të Departamentit, është ngritur Komisioni i Posaçëm për zbatimin e vendimit Nr. 1459, datë 13.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, sipas përcaktimeve të tij.

Komisioni i Posaçëm bëri një hetim administrativ me:

- a) Shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor formë të prerë, në favor të kreditorit gjyqësor;
- b) Shqyrtimin e rasteve kur urdhërimet e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitore, sipas dispozitivit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- c) Shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqësorit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, sipas kriterëve të pozicionit të punës dhe kategorisë përkatëse, brenda Departamentit të Administratës Publike, duke ju referuar dispozitivit të vendimit për të rikthyer paditësin në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend tjetër të së njëjtës kategori, që ka patur në momentin e lirimit nga shërbimi civil.

Komisioni, pasi shqyrtoi kriteret e përgjithshme e specifike të pozicionit të punës përpara lirimit tuaj, si Koordinator për Politikën e Rekrutimit dhe Konfirmimit pranë DAP, me kategori page III-a, me kriter specifik shkencë juridike, si dhe pozicioneve aktuale të lira në Departamentin e Administratës Publike, konkludoi se i vetmi pozicion pune ku ju plotësoni kriteret e përgjithshme e specifike është:

-Përgjegjës i Sektorit të Integritetit dhe Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore, në DAP, me kategori page III-a, me kriter specifik shkenca juridike.

Komisioni i Posaçëm, në zbatim të Kreut IV të Urdhrit Nr.5151, datë 28.10.2015, "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", vendosi t'ju njoftojë me shkrim, për pozicionin e ofruar, si rezultat i zbatimit të vendimit të formës së prerë.

Gjyqfituesi brenda 3 ditëve duhet të njoftojë me shkrim Komisionin e Posaçëm për pëlqimin apo refuzimin e alternativës së propozuar.

KOMISIONI I POSAÇËM

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Sekretarë Teknikë
Agathi Kuramano	Andrea Treska	Marcela Gërëku	Dalila Dako	Rovilda



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE
ADMINISTRATIVE E GJYQËSORE

Nr. 4353/1 prot.

Tiranë, më 22.07.2019

PROCES VERBAL

Komisioni Posaçëm i mbledhur më datë 22.07.2019, asistuar nga sekretarja teknike znj. Rovalda Mema, mori në shqyrtim administrativ faktet dhe rrethanat e reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë, Nr. 1459, datë 13.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, në favor të gjyqfituesit z. Marjel Mejdini, për sistemimin në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, sipas kriterëve të pozicionit të punës dhe kategorisë përkatëse, brenda institucionit të Departamentit të Administratës Publike.

Komisioni i Posaçëm, ngritur me Urdhërin nr. 49, datë 17.07.2019, të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm (KP) për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë" përbëhet nga:

- **Agathi Kuramano** Kryetar i Komisionit- (Drejtor e Drejtorisë së Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil);
- **Andrea Treska** Anëtar- (Përgjegjës i Sektorit Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse);
- **Marcela Kërëku** Anëtar- (Përgjegjëse e Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore);
- **Dalina Dako** Anëtar- (Specialiste Financë/Buxhet në Sektorin Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse).
- **Rovalda Mema** Sekretare Teknike

Znj. Marcela Kërëku paraqiti situatën mbi ecurinë e deritanishme të procesit, si dhe informoi shkurtimisht mbi procedurën ligjore të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, mbështetur në Vendimin Nr. 1459, datë 13.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe në modalitetet e përcaktuara në Urdhërin nr. 5151, datë 28.10.2015, "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil".

Z. Marjel Mejdini, ka mbajtur detyrën e Koordinatorit për Politikën e Rekrutimit dhe Konfirmimit pranë DAP, me kategori III-a. Me urdhërin e Kryeministrit Nr. 204, datë

1.11.2013, "Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Kryeministrisë". DAP ka pësuar ndryshime strukturore si dhe në kompetenca. Padiësi, në kuadër të ristrukturimit për shkak të Urdhërit të Kryeministrit, me aktin nr. 1584/1, prot. datë 06.11.2013, ka kaluar në listë pritje, akt të cilin e ka pranuar dhe nënshkruar.

Padiësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt: Pavlefshmëria absolute e shkresës Nr. 1591/10 datë 06.11.2013 "Njoftim për kalim në listë pritje" e Drejtorit të DAP znj. Albana Kociu, rikthim në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend tjetër në të njëjtën kategori që kisha në momentin e lirimit nga shërbimi civil. Pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, deri në rikthim.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka shpallur Vendimin Nr. 3819(80-2017-3891) datë 09.10.2017, me të cilin ka vendosur:

- 1. Pranimin e padisë së palës padiëse.*
- 2. Konstatimin e pavlefshmërisë së shkresës Nr. 1591/10 datë 06.11.2013 "Njoftim për kalim në listë pritje" të Drejtorit të Departamentit të.*
- 3. Detyrimin e palës së paditur të rikthejë padiësin në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend tjetër të së njëjtës kategori që ka patur në momentin e lirimit nga shërbimi civil.*
- 4. Detyrimin e palës së paditur të paguaj padiësit pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin në punë.*

Gjykata Administrative e Apelit ka shpallur Vendimin Nr. 1459 datë 13.05.2019, me të cilin ka vendosur:

"Lënie në fuqi të Vendimit Nr. 3819 (80-2017-3891) datë 09.10.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë".

Në datën 05.07.2019 gjyqfytuesi Marjel Mejdini i është drejtuar me kërkesë Departamentit të Administratës Publike për ekzekutimin vullnetar të detyrimit sipas vendimit të formës së prerë.

Në datën 17.07.2019, me urdhër të Drejtorit të Departamentit, është ngritur Komisioni i Posaçëm për zbatimin e vendimit Nr. 1459 datë 13.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit sipas përcaktimeve të tij.

Komisioni i Posaçëm bëri një hetim administrativ me :

- Shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor formë të prerë, në favor të kreditorit gjyqfytues;
- Shqyrtimin e rasteve kur urdhërimet e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitoare, sipas dispozitivit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- Shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqfytuesit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, sipas kritereve të pozicionit të punës dhe kategorisë përkatëse,

brenda Departamentit të Administratës Publike, duke ju referuar dispozitivit të vendimit për të rikthyer paditësin në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend tjetër të së njëjtës kategori, që ka patur në momentin e lirimit nga shërbimi civil.

Komisioni, pasi shqyrtoi kriteret e përgjithshme e specifike të pozicionit të punës përpara lirimit të gjyqfituesit, Marjel Mejdini, si Koordinator për Politikën e Rekrutimit dhe Konfirmimit pranë DAP, me kategori page III-a, me kriter specifik shkencë juridike, si dhe pozicioneve aktuale të lira në Departamentin e Administratës Publike, konkludoi se i vetmi pozicion pune ku Z. Mejdini plotëson kriteret e përgjithshme e specifike është:

-Përgjegjës i Sektorit të Integritetit dhe Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore, në DAP, me kategori page III-a, me kriter specifik shkencë juridike.

Komisioni i Posaçëm, në zbatim të Kreut IV të Urdhrit Nr.5151, datë 28.10.2015, "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", vendosi të njoftojë me shkrim gjyqfituesin Marjel Mejdini për pozicionin e ofruar, si rezultat i zbatimit të vendimit të formës së prerë.

Gjyqfituesi brenda 3 ditëve duhet të njoftojë me shkrim Komisionin e Posaçëm për pëlqimin apo refuzimin e alternativës së propozuar.

Komisioni i Posaçëm :

Znj. Agathi Kuramano

Kryetar

Sekretare Teknike

Z. Andrea Treska

Anëtar

Rovalda Mema

Znj. Marcela Kërëku

Anëtar

Znj. Dalina Dako

Anëtar

2. Komisioni i Posaçëm ngarkohet me këto detyra:


- a) Shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor formë të prerë, në favor të kreditorit gjyqësues;
- b) Shqyrtimin e rasteve kur urdhërimet e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitore, sipas dispozitivit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- c) Shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqësuesit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, sipas kriterëve të pozicionit të punës dhe kategorisë përkatëse, brenda Departamentit të Administratës Publike.

3. Ngarkohet Komisioni i Posaçëm për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR DEPARTAMENTI

Albana Koçiu



Al - Kociku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE
ADMINISTRATIVE E GJYQËSORE

Nr. 4359/3 prot.

Tiranë, më 02.08.2019

PROCES VERBAL

Komisioni Posaçëm i DAP mori në shqyrtim administrativ faktet dhe rrethanat e reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë, Nr. 1459, datë 13.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, në favor të gjyqfituesit z. Marjel Mejdini, për sistemimin në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, sipas kriterëve të pozicionit të punës dhe kategorisë përkatëse, brenda institucionit të Departamentit të Administratës Publike.

Komisioni, pasi shqyrtoi kriteret e përgjithshme e specifike të pozicionit të punës përpara lirimit të gjyqfituesit, Marjel Mejdini, si Koordinator për Politikat e Rekrutimit dhe Konfirmimit pranë DAP, me kategori page III-a, me kriter specifik shkencë juridike, si dhe pozicioneve aktuale të lira në Departamentin e Administratës Publike, konkludoi se i vetmi pozicion pune ku Z. Mejdini plotëson kriteret e përgjithshme e specifike është:

-Përgjegjës i Sektorit të Integritetit dhe Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore, në DAP, me kategori page III-a, me kriter specifik shkencë juridike.

Komisioni i Posaçëm, në zbatim të Kreut IV të Urdhrit Nr.5151, datë 28.10.2015, "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", vendosi të njoftojë me shkrim gjyqfituesin Marjel Mejdini për pozicionin e ofruar, si rezultat i zbatimit të vendimit të formës së prerë.

Në datën 22.07.2019, në zbatim të nenit 158 e vijues të K.Pr. Administrative me Nr. 4359/1 dhe 4359/2 Prot., janë dërguar në adresën e Z. Marjel Mejdini, Rruga: "Zef Jubani" Pallati "Bjorn", Kati i I, Tiranë, me postën zyrtare: Njoftimi për Propozimin e Komisionit të Posaçëm për një pozicion të lirë pranë DAP për gjyqfituesin Marjel Mejdini, përfshirë dhe procesverbalin e mbledhjes së Komisionit të Posaçëm dhe urdhrin e ngritjes së Komisionit të Posaçëm.

Nga posta shqiptare kthehet zarfi me shënimin "i panjohur". Po në këtë ditë, një nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm, Znj. Marcela Kërëku ka telefonuar Z. Marjel Mejdini dhe i ka kërkuar saktësimin e adresës apo marrjen e zarfit personalisht prej tij në zyrën e protokollit të DAP. Z. Mejdini ka saktësuar adresën me ëhatts up, respektivisht Kruga: "Zef Jubani", Pallati "Bjorn", kati i 7, Apartamenti 51, Tiranë.

Zyra e Protokollit pranë DAP në datën 26.07.2019 me Nr. 4359/1 dhe 4359/2 Prot., ka dërguar në adresën e Z. Marjel Mejdini me postën zyrtare: Njoftimi për Propozimin e Komisionit të Posaçëm për një pozicion të lirë pranë DAP për gjyqfituesin Marjel Mejdini, përfshirë dhe procesverbalin e mbledhjes së Komisionit të Posaçëm dhe urdhrin e ngritjes së Komisionit të Posaçëm.

Nga posta shqiptare kthehet zarfi me shënimin "larguar me pushime". Në këto kushte përsëri nga anëtari i KP Znj. Marcela Kërëku është telefonuar në numrin e tij personal 0684018096 Z. Marjel Mejdini, në datën 26.07.2019 ora 10:09 dhe ai ka deklaruar se do të vinte ta merrte personalisht zarfin te protokollit i DAP po nuk është paraqitur. Në datë 02.08.2019 ora 09:30, është telefonuar përsëri për t'ja dorëzuar personalisht zarfin po nuk është përgjigjur. Në këto kushte i është lënë shënimi në ëhatts up, ku rezulton se është lexuar prej tij "Të lutem më nis një adresë emaili të të nis të skanuar njoftimin e Komisionit të Posaçëm për zbatimin e vendimit tuaj".


Në kushtet kur 2 zarfet me postën shqiptare janë kthyer, është telefonuar 2 herë për t'ja dhënë personalisht zarfet po nuk ju është përgjigjur, i janë lënë shënimet në rrjetet e tjera sociale, por pa sukses, në bazë të pikës "b" të nenit 162 të K.Pr. Administrative "Kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi; vendos njoftimin publik të akteve për gjyqfituesin Marjel Mejdini.

1 kopje e shpalljes së shkresës vendoset në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e DAP.

1 kopje e publikon në faqen e tij të internetit.

Tiranë më 02.08.2019

Komisioni i Posaçëm :

Znj. Agathi Kuramano  Kryetar

Z. Andrea Treska

Anëtar 

Znj. Marcela Kërëku

Anëtar 

Znj. Dalina Dako

Anëtar 

Sekretare Teknike

Rovalda Mema 